



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.

Prot.

Tiranë ___/___/2020

Nr.Dok.202002819/2

Lënda : Rekomandim për marrjen e masave në rastin e shoqërimit të të miturve nga punonjësit e Policisë së Shtetit

MINISTRISË SË BRENDSHME

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Për dijeni:

**AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E
FËMIJËS**

TIRANË

Institucioni i Avokatit të Popullit është vënë në dijeni nëpërmjet emisionit investigativ "Stop" në televizionin kombëtar Klan, lidhur me shoqërimin dhe intervistimin e të miturës 12-vjeçare në komisariatit e Policisë së Shtetit në Fier, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, për administrimin e drejtësisë penale për të mitur.

Në pamjet e transmetuara evidentohet qartësisht, mosrespektimi dhe mosfunksionimi i mekanizmave efektive të institucioneve shtetërore, të ngarkuara

me marrjen e masave konkrete, për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes “*ex-officio*” për rastin në fjalë. Një ndër aktorët kyç, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, është edhe Policia e Shtetit¹. Po kështu, referuar parashikimeve të ligjit organik të Policisë së Shtetit, ky institucion ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut².

Në përputhje me standardet ndërkombëtare për administrimin e drejtësisë penale për të mitur, në funksion të garantimit dhe të respektimit të interesit më të lartë të fëmijës në procesin penal, është miratuar një ligj i veçantë, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregullat procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër, që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Qëllimi i këtij ligji është që të garantojë një kuadër ligjor mbi drejtësinë penale për të mitur, në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare, që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të tij. Qëllimi dhe fryma e këtij ligji, në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës është, se pavarësisht rolit që ka i mituri në një proces penal, qoftë aktiv (në konflikt me ligjin), qoftë pasiv (viktimë dhe/apo dëshmitar), atij duhet t’i garantohet në mënyrë të posaçme një proces ligjor i dedikuar, për të mos përkeqësuar traumën e përjetuar nga i mituri, si edhe duke nxitur dëshirën për edukim dhe riintegrim në shoqëri. Kjo u jep fëmijëve mundësinë më të mirë për të jetuar një jetë të shëndetshme dhe të përmbushur, të rriten për të qenë adultë të lumtur dhe produktivë, u mundëson të jetojnë fëmijërinë e tyre dhe, passjell përfitime shumë të mëdha edhe për shoqërinë.

I mituri në konflikt me ligjin, viktimë dhe/apo dëshmitar, gëzon të drejtat e parashikuara, jo vetëm në Kodin e Procedurës Penale, por edhe të drejtat e

¹ Pika 3, e nenit 52, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, parashikon se: “...*grupi teknik ndër sektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë...*”.

² Neni 2, i ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Kështu, në rastet e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të të miturit dhe shoqërimit të tij në komisarate, detyrimisht njoftohet familja, përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi, psikologu³, etj. Në çastin e shoqërimit/ndalimit/arrestimit, të miturve u bëhet i qartë shkaku i kufizimit të lirisë dhe u komunikohen të drejtat dhe garancitë procedurale. Të miturit merren në pyetje nga specialistë të Policisë së Shtetit⁴, pasi janë njoftuar prindërit apo përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi, si dhe psikologu, që do të thotë, se pyetja e të miturit (sidomos atyre nën 14 vjeç), mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor/procedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij⁵. Sikundër, sjellim në vëmendje, se asnjë i ndaluar nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit/dënimit mizor, çnjerëzor poshtërues, ose ndonjë forme dhune ose kërcënimi dhe, sidomos në rastet e të miturve, kjo është thelbësore.

Fëmijët duhet të trajtohen në atë mënyrë, që promovon ndjenjen e tyre të dinjitetit njerëzor dhe vlerave, që lehtëson riintegrimin e tyre në shoqëri (të miturit në konflikt me ligjin), që pasqyron interesin më të lartë të fëmijës dhe, merr parasysh nevojat e moshës.

Nenet 6, pika 2, 5, pika 9 dhe 23, pika 1, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcaktojnë, se realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve mbështetet në një nga parimet kryesore, që Konventa e OKB-së dhe ky ligj parashohin, atë të respektimit të dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës, duke garantuar kështu, zhvillim të qëndrueshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social. Realizimi në praktikë i këtij parimi nga ana e autoriteteve shtetërore përgjegjëse, do të thotë ofrimi i mbrojtjes për fëmijët nga çdo lloj forme dhune, duke i ofruar mbrojtje⁶.

Me qëllim mbrojtjen e fëmijës, është i domosdoshëm ofrimi i shërbimeve, sipas nevojave si dhe realizimin e ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e të miturit. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme, që të miturit në konflikt me ligjin, viktime dhe/apo dëshmitarë në një vepër penale, të intervistohen në një mjedis të posaçëm, për të shmangur çdo

³ Nenet 18 dhe 19, të ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë penale për të Mitur”

⁴ Neni 25, i ligjit nr.37/2017, parashihet në mënyrë të hollësishme, detyrimin e organeve kompetente, për marrjen e masave të duhura, për të siguruar, që : “...*personat, të cilët punojnë me të miturit, të kenë njohuritë e nevojshme, ndërgjegjësimin profesional më të lartë për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktime ose dëshmitarë...*”.

⁵ Shih nenin 42, të ligjit nr.37/2017.

⁶ “Mbrojtje e fëmijës”, është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

kontakt, jo vetëm me pjesën tjetër të punonjësve të policisë brenda komisariatit, por edhe me çdo të dyshuar, të shoqëruar apo të ndaluar tjetër në mjediset e komisariatit.

Në përfundim, në mbështetje të legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektoral në nivel qendror dhe vendor, për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, mbrojtja nga çdo formë e dhunës neglizhencës e abuzimit seksual dhe forcimi i shëndetit fizik e emocional të fëmijëve, është një komponent i të drejtave të tyre, në interesin më të lartë, si dhe duhet të ketë përparësi të jashtëzakonshme.

Është detyrë e të gjithëve së bashku, që në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe, në zbatim të parimit të interesit më të lartë të tyre, të përpiqemi t'u garantojmë një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimin e një jetese të shëndetshme e pa privime.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre, në zbatim të legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës dhe, në përcaktimin e qartë të detyrave të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave, për rritjen e bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit të punës me strukturat e tjera, të cilat ofrojnë shërbime publike, për të mundësuar mbështetjen e të miturit në konflikt me ligjin në procesin penal. Kjo ndihmë mund të përfshijë masa konkrete për minimizimin e pasojave negative të veprës penale dhe ndihmon të miturin në veprimtarinë e përditshme për çështjet administrative, që lidhen me rrethanat e rastit konkret.
- Marrjen e masave nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për të filluar hetimin administrativ ndaj punonjësit/ësve të policisë në komisariatit e Fierit, të cilët me veprimet e tyre, qartazi kanë

shkelur procedurat standarde që parashikon legjislacioni në fuqi, në rastet e intervistimit të të miturit në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitarë, duke ceduar e cenuar të drejtat e fëmijës.

- Marrjen e masave, për kryerjen e intervistave me të miturit në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitarë, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme të intervistimit, në bazë të gjendjes dhe nevojave specifike të të miturit, ashtu sikundër parashikon edhe shkronja “dh”, të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr.37/2017.
- Marrjen e masave, për të siguruar marrjen në pyetje të të miturit në një mjedis miqësor, duke krijuar kushtet e përshtatshme në përputhje me gjininë, gjendjen shëndetësore dhe psikologjike të tij, sipas përcaktimeve në nenin 33, të ligjit nr.37/2017. Marrja në pyetje zhvillohet pa ndërprerje dhe pa ndërhyrjen e personave të paautorizuar.
- Marrjen e masave, për krijimin e mjediseve apo hapësirave të përshtatshme në komisariatet e policisë, anëmbanë vendit, për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitarë.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA